



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:098180
Datë: 18.11.2024
Numri i dokumentit: 06464608

CN.nr.61/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, në çështjen jokontestimore të propozuesit I.T.nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.H.nga GJ., kundër kundërpropozuesve S.Z.dhe S.B., që të dy nga P., me objekt kontesti ndarja fizike e paluajtshmërive, pas mbajtjes së seancës gjyqësore të datës 18.11.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Konsiderohet i tërhequr propozimi i propozuesit I.T.nga P., i ushtruar kundër kundërpropozuesve S.Z.dhe S.B., që të dy nga P., për ndarje fizike të paluajtshmërive.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Propozuesi I.T.në këtë gjykatë ka paraqitur propozim ndaj kundërpropozuesve S.Z.dhe S.B., me objekt kontesti ndarja fizike e paluajtshmërive.

Gjykata ka caktuar seancë lidhur me këtë çështje për datë 18.11.2024, në orën 09:00, në të cilën seancë ka munguar pa arsye /ose së paku nuk ka prova se mungesa e palëve është e arsyetuar/ përfaqësuesi i propozuesit, K.H.nga GJ., i cili ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë, fakt që konstatohet nga fletëkthesa e kthyer në gjykatë, e pranuar nga përfaqësuesi i propozuesit më datë 16.10.2024.

Andaj, gjykata, duke vepruar konform nenit 12.3 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore /Ligji Nr. 03/L-007/, ku është paraparë se “Konsiderohet se propozuesi e ka tërhequr propozimin po qe se nuk vjen në seancën e parë për të cilën është thirrur në mënyrë të rregullt”, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:098180
Datë: 18.11.2024
Numri i dokumentit: 06464608

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHME - DIVIZIONI CIVIL
2023:098180, 18.11.2024

Gjyqtari
Berat Spahiu

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.